

Informacioni mbi procedimin Penal Nr 53 viti 2017

Ne baze te informacioneve dhe te dhenave te grumbulluar ne shkurt te vitit 2017 ne Prokurorine Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda -Tirane eshte rregjistruar Procedimi penal Nr 53 per vepren penale ate "Dhenies ndihme per kalim te paligjshem te kufirit", parashikuar nga neni 298/a te K.Penal.

Pershkrimi i Operacionit "One if by Land"

Procedimi Penal Nr 53 Viti 2017(Prokuror Eugen Beçi)

1. Vepra Penale

"Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit në kuadër të grupit të strukturuar kriminal "parashikuar nga nenet 298/a ,333/a-1,2 e 334 të Kodit të Penal.

2. Koha, vendi dhe modus operandi

Spektori per Hetimin e Trafikut te Paligjshëm ne saj te informacioneve te grumbulluar ne Shkurt te vitit 2017 ka referuar materialet ne Prokurorinë prane Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për një grup kriminal që ushtronte veprimtarinë kriminale atë të dhënies ndihmë për kalimi të paligjshëm të kufirit.Në bazë të këtij materiali Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda -Tiranë ka rregjistruar procedimi penal Nr 53 për veprën penale "Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal ", parashikuar nga nenet 298/a, 333/a të Kodit Penal.Grupi kriminal e kishte shtrirë aktivitetin e tij jashtë territorit të Shqipërisë si në Maqedoni, Bullgari, Kosovë Slloveni, Itali, Spanjë ,Portugali, Francë, Irlandë deri në vendet e Amerikës Latine. Grupi kriminal në fokus të veprimtarisë së tij kishte dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit kundrejt pagesës shtetasve që dëshironin të emigronin në mënyrë të paligjshme kryesisht në shtetet si Irlandë Mbretëri e Madhe, SHBA/Kanada, shtete në të cilat vëtem me viza mund të udhëtosh.Shtetasit që dëshironin të emigronin në mënyrë të paligjshme kundrejt pagesave ishin shtetas Shqiptar.

- Nga hetimet e kryera u arrit të mësohej sesi grupi kriminale funksiononte, anëtarët e tij ishin shtetas Shqiptar, Maqedonas, Bullgar , secili anëtarë sipas hirarkise të grupit kishte rolin e vet duke filluar.
- Personat që siguronin kontaktet me personat e interesuar për të emigruar në mënytrë të paligjshme në drejtim të Mbretërisë së Bashkuar, ShBA dhe Kanada.
- Personat që ishin garantë dhe mbajtës të vlerave monetare që paguheshin nga personat e interesuar për të emigruar në mënyrë të paligjshme.
- Personat që siguronin rezervimet e udhëtimeve dhe akomodimin e të interesuarve për të emigruar në mënyrë të paligjshme (klientët).
- Personat që siguronin dhe prodhonin dokumentat e falsifikuara.
- Personat që transportonin dokumentat e falsifikuara.
- Personat që kryenin transportimin dhe shoqërimin e personave të kontrabanduar.
- Personat bë bënin pritjen e tyre dhe akomodimin në hotel deri në momentin e udhëtimit drejt destinacionit filal.
- Organizatori i aktivitetit kriminal (Shefi).

Menyra e organizimit te kontrabandimit te personave nga ana e grupit kriminal

Grupi kriminal për të realizuar kontrabandimin e personave kundrejt pagesave përdorte këtë mënyrë;

Fillimisht pasi arrihej të binin dakort për shumën e pagesës, e cila varion nga 7000 deri në 9000 paund për në Mbretërinë e Bashkuar dhe 25000 deri në 30000 dollarë për në ShBA/Kanada, me personat që do të emigronin në mënyrë të paligjshme, anëtarët e grupit kriminal merrnin gjeneralitetet e personave, fotografi të tyre dhe dokumentat e identifikimit i dërgonin ose dorazi ose nëpërmjet rrjeteve sociale(ëhatsap, viber) për tek personi që do siguronte/prodhonte dokumentat e udhëtimit të falsifikuara, paralelisht me këtë anëtarët e tjerë të grupit kriminal kryenin rezervimin e linjave të udhëtimit,

ajërore, tokësore vajtje -ardhje (në shumicën e rasteve ishin fiktive) si me dokumenta udhëtimi shqiptare ashtu dhe me ato me dokumenta udhëtimi të falsifikuara sipas rastit, duke mbajtur parasysh që shfrytëzoheshin pikat e kalimit kufitare ku kontrollet ishin të dobta. Pjesë e grupit kriminal ishin dhe personat që do të kryenin shoqërimin/ transportimin/pritjen e personave që do të kontrabandoheshin.

Zakonisht shtetasit që do të emigronin udhëtonin me dokumenta shqiptare deri në vendet kryesisht të Bashkimit Europian, ku udhëtimi nuk kërkon vizë. Si shtete tranzit për destinacion final Mbretërinë e Bashkuar, përdorshin shtetet e BE si Franca, Spanjë, Itali me qëllim për të emigruar në mënyrë të paligjshme, kurse për të emigruar në mënyrë të paligjshme në drejtim të SHBA/Kanada, janë përdorur si shtete tranzit, Meksika, Panamaja dhe Republikë Domenikane. Shtetasit që do të emigronin në mënyrë të paligjshme, pas mbërritjes në një nga shtetet e mësipërme europiane, futeshin në zonën e tranzitit po në këtë moment fshihnin dokumentat e vërtetat të udhëtimit dhe vini në përdorim dokumentin e falsifikuar të udhëtimit ku kishin bërë dhe rezervimin e biletës së avionit për në destinacionin e dëshiruar si në Angli, SHBA/Kanada.

Në përgjithësi në rastet që kemi konstatuar, dokumentat e udhëtimit të falsifikuara, ju jepeshin personave që do të emigronin në mënyrë të paligjshme në momentin e fundit kur do të kryenin levizjet në zonën tranzit.

Në hetimet e kryera kemi konstatuar dhe kemi pasur dyshime se një pjesë e dokumentave të udhëtimit të falsifikuara siguroheshin në vend kurse pjesa tjetër grupet kriminale i siguronin nga bashkëpunëtorët e tyre jashtë Shqipërisë.

- Bashkëpunimi nderkombëtar

Në saj të hetimeve dhe bashkëpunimit me partnerët tanë kemi aritur të parandalojmë dhe të kapim brenda një viti mbi 200 raste ku grupi kriminal ka organizuar kontrabandimin e tyre.

Për shkak të shtrirjes së aktivitetit kriminal të këtij grupi në shumë shtete dhe hetimet janë koordinuar me shumë agjenci ligjzbatuese si D.S.A(Departamenti i sigurisë Amerikane , pranë ambasadës Amerikane në Tiranë)SELEC, EUROPOL, INTERPOL. Për këtë arsye në funksion të hetimeve janë kryer disa takime operacionale sic janë takimet e zhvilluara në;

Maqedoni datat 03.05.2017, 29.09.2017

Bullgari datë 31.01.2018

Europol datë 10.02.2018.

Në pjesen më të madhe të shkëmbimit të informacionit duke pasur parasysh dhe specifikat e shtrirjes së veprimtarisë kriminale të grupit është kryer nëpërmjet SELEC-ut .Paralelisht me hetimet që kemi kryer këtu në Shqipëri kanë rregjistruar /celur procedime edhe shtetet si Maqedoni, Bullgari, Spanje, Francë, Angli.

Metodat e Hetimit

Në hetimin e kësaj ceshtje për të argumentuar veprimtarinë e anëtarëve të grupit kriminal në Shqipëria nga ana jonë janë përdorur metodat speciale të hetimit sic janë; vëzhgimi, filmimi, fotografimi, përgjimi i numrave të telefonit të subjekteve nën hetim .

3. Rezultatet e Operacionit” **One if by Land**” i cilë është finalizuar në 18 Mars të vitit 2018.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda-Tiranë me vendimin Nr 71 datë 16.03.2018 ka caktuar masën e sigurimit “Arrest me burg për 51 shtetas shqiptarë të implikuar, nga të cilët janë ekzekutuar 39 të tillë dhe 12 shtetas janë shpallur në kërkim,

Të arrestuar:

- 1. A.C. Ardian Pjetër CORRI**, i datëlindjes 15.10.1971, lindur në Gurëz -Krujë e banues në Njësia Bashkiake Nr 9, ”Rr Mahmut Fortuzi”pallat i Ri -Tiranë
- 2. L.Q, . Luan Xhezar QYRKU**, i datëlindjes 25.02.1958, lindur dhe banues në Tiranë.
- 3. E.M, Eno Riza MUÇOLLARI**, i datëlindjes 24.03.1961, lindur dhe banues në Tiranë
- 4. A.G, Ardian Ali GURAKUQI**, i datëlindjes 27.04.1960, lindur në Elbasan dhe banues Tiranë.
- 5. Z.H, Zaim Ferik HYSENBELLIU**, i datëlindjes 04.04.1961 lindur në Skrapar dhe banues në Njësia Bashkiake Nr 7 Rr.Besim Imami-Tiranë
- 6. A.K, Arben Bajram KAJAÇI**, i datëlindjes 09.02.1969, lindur dhe banues në Tiranë.

7. **G.O, Genci Rahim OSMANAJ**, i datëlindjes 06.01.1969, lindur dhe banues në Tiranë
8. **O.S, Oltjan Teki SERANI**, i datëlindjes 27.01.1985, lindur në Përmet e banues Tiranë.
9. **T.P, Tanush Mark PRENGA**, i datëlindjes 04.03.1970, lindur në Shullaz Krujë dhe banues në Laç Kurbin
10. **L.M, Liri Hydbi MUÇOLLARI**, e datëlindjes 27.04.1963, lindur në Çorovodë banues në Tiranë.
11. **F.Z, Fuat Hasan ZAIMI**, i datëlindjes 24.07.1967, lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë
12. **N.P, Nikolin Tush PRISKA**, i datëlindjes 16.03.1969, lindur dhe banues në Tiranë
13. **Y.R, Ylber Belul RAMA**, i datëlindjes 06.06.1974, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë.
14. **H.T . Haki Petrit TARJA**, i datëlindjes 30.05.1968, lindur dhe banues në Tiranë
15. **B.B, Bedri Avni BENDAJ**, i datëlindjes 05.04.1963, lindur ne Plashnik –Berat, e banues në Njesia Bashkiake Nr 2-Bathore –Tiranë.
16. **E.A, Erenik Xhemal AVDYLI**, i datëlindjes 16.04.1988 lindur e banues Njësia Bashkiake Nr 8 Don Bosko Kulla Nr 2 – Tiranë.
17. **N.B, Nike Mark BUSHI**, i datëlindjes 11.05.1953 lindur në Kqir dhe banues në Dobrac-Shkodër.
18. **K.V, Kolë Zef VUSHAJ**, i datëlindjes 22.01.1969 lindur e banues në Vermosh –Malësia e Madhe.
19. **B.V, Besnik Caf VUÇAJ**, i datëlindjes 25.01.1969 lindur e banues në Golem Shkodër, por rezident në Irlandë .
20. **A.K Alfred Kolë KALAJ**, i datëlinjdes 04.07.1986 lindur në Koplik dhe banues në Kamicë-Malësië e Madhe.
21. **M.Z, Mhill Mark ZEFI**, i datëlindjes 25.05.1976 lindur e banues në Plan-Gjuraj –Pult Shkodër.
22. **N.V, Nosh Mark VOLAJ**, i datëlindjes 26.10.1973 lindur e banues në Broje Malësi e Madhe-Shkodër.
23. **P.GJ Prel Gjeto GJELAJ**, i datëlinjdes 08.09.1964 lindur e banues në Broje, Malësi e Madhe –Shkodër.
24. **S.D, Sokol Gjergj DULI**, i datëlindjes 07.09.1969 lindur e banues në Tale –Lezhë.

25. **E.D, Euglen Skënder DUSHKU**, i datëlindjes i datëlindjes 11.05.1986 lindur e banues në lagjen Varosh-Lezhë.
26. **L.D, Leonora Luigj DUSHKU**, e datëlindjes 10.10.1985, lindur në Zejmen e banuese në lagjen Varosh-Lezhë.
27. **R.F. Roza Leke FRROKU**, e datëlindjes 14.10.1978 lindur në Ballsh-Fier e banuese në lagjen Varosh-Lezhë.
28. **B.B, Blerim Agim BRAHIMI**, i datëlindjes 04.07.1982 lindur e banues në lagjen Besëlidhja- Lezhë.
29. **L.SH, Luigj Gjin SHTINJA**, i datëlindjes 21.09.1966, lindur dhe banues në Laç Kurbin.
30. **E.C, Esat Imer ÇAKONI**, i datëlindjes 10.05.1966, lindur dhe banues në Laç Kurbin.
31. **F.M, Fatos Emin MUJA**, i datëlindjes 28.08.1970 lindur e banues në Shtiqën -Kukës
32. **K.M, Kreshnik Emin MUJA**, i datëlindjes 01.11.1983 lindur e banues në Shtiqën-Kukës.
33. **A.K, Artur Faik KARAJ**, i datëlindjes 15.01.1975, lindur dhe Banues në Arrameras Krujë.
34. **K.Z, Kristjan Gjeto ZALLINAJ**, i datëlindjes 16.01.1997, lindur në Gimaj e banues Shtoj i Ri Shkodër.
35. **M.S, Mensur Hysni SELAMI**, i datëlindjes 02.02.1965 lindur e banues në Dubrovë-Peshkopi.

Njëkohësisht janë janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e 12 shtetasve të tjerë, të dyshuar si të përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

(B.S, Bashkim Jakup SORRA, i datëlindjes 28.12.1956, lindur dhe banues në Tiranë

I.F, Ilir Rexhep FEÇI, i datëlindjes 20.09.1965 lindur në Kukës e banues në Njësia Bashkiake Nr 10.Kavajës-Tiranë

S.H, Sajmir Niazi HYSENBELLIU, i datëlindjes 03.11.1972 lindur në Skrapar dhe banues ne Tirane

E.K, Enxhi Shkëlqim KOÇI, i datëlindjes 03.10.1992 lindur në Kucove e banues -Tiranë **P.K, Përparim Qani KULE**, i datëlindjes 01.02.1957, me kombësi Shqiptare dhe shtetësi Shqiptare, Kombinat Tiranë

S.K, Skënder Qamil KOÇI (KENI), i datëlindjes 20.09.1954, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, rezident në Bullgari

SH.K, Shkëlqim Qamil KOÇI (JIMMY), i datëlindjes 12.12.1965, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, rezident në Bullgari

A.Ç, Adriatik Dodë ÇEKAJ, i datëlindjes 28.03.1979 lindur e banues në Tamarë –Malësi e Madhe-Shkodër

J.SH, Jorgo Përparim SHAHO, i datëlindjes 27.08.1977 lindur e banues në Njësia Bashkiake Nr 3, "Rr Ali Baushi" –Tiranë

B.K, Borislav IvanovKrumov i datëlindjes 23.07.1988, lindur e banues në Bullgari

M.V, Marin Dimitrov Vasilev i datëlindjes 18.11.1968 lindur e banues në Bullgari

Gjatë kontrollit të ambjenteve dhe vendeve të dyshuara që përdorëshin nga autorët, janë gjetur dhe sekuestruar disa prova materiale si:

- 10 njesi qëndrore (kompjuteri)
- 8 printera lazer me ngjyra
- 15 laptop, 3 I-pad,
- 4 boje printeri
- 56 aparate telefonash
- 17 automjete
- 12 CD
- 4 USB
- 5,600 euro, 1,000 \$ dhe 3400.000 leke
- 5 pasaporta ndërkombetarë shqiptare
- 2 pasaporta Boshnjake
- 13 vertetime për leje pune të falsifikuara
- 7 çertifikata personale italiane
- 4 karte identiteti italiane
- 1 deftesë pjekurie shqiptare
- 2 leje drejtimi
- 8 certifikata personale shqiptare të pa plotësuar
- 2 leje kalimi
- 1 raport mjekësor
- 7 karta telefoni SIM

- 11 karta banke
- 6 karta identiteti të huaja të vendeve të BE-së
- 1 arme zjarri automatik mod 56 dhe 13 fisheke
- 1 arme gjahu.
- 2 karta krediti
- 2 libreza pune

Ne vijim te hetimeve te kryer ne funksion te ketij procedimit penal Nr 53 viti 2017 ne baze te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare per krimet e Renda Gjykata e Shkalles se Pare Nr 137. datë 28.09.2018 e cila ka vendosur masen e sigurise "Arrest me burg", per veprat penale ' **Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve" kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 298, 333/a e 334 të K.Penal" parashikuar nga neni 248 i K.Penal.**

Ne date 28.09.2018 ne zbatim te vendimit te mesiperme te Gjykates jane kryer veprimet hetimore per 8 shtetas , 5 shtetas Maqedonas si dhe 3 shtetas Shqiptar nga ky vendim jane ekzekutuar masa e sigurise per dy shtetasit shqiptar (punonjes policie) qe jane si meposhte ;

- 1. Edmond Llacini i datelindjes 09.06.1984**
- 2. Almir Doda i datelindjes 22.09.1976**

Nderkohe jane shpallur ne kerkim shtetasit;

E.S. Emilian Sinjari i datelindjes 18.11.1992 lindur e banues ne Shqiperi

Betim Veliu i datelindjes 13.09.1985 lindur e banues ne Maqedoni e Veriut.

Ilia Mitrevski i datelindjes 02.08.1966 ‘ ‘ ‘

Artim.Dauti i datelindjes 30.08.1979 ‘ ‘ ‘

Genc Dibra i datelindjes 22.05.1972’ ‘ ‘

Zaim Dauti i datelindjes 28.11.1970 ‘ ‘

Ne datw 04.10. nga e autoriteteve Maqedonase ne funksion te ketij hetimi kane kryer Operacionin "Passaporta" .Ku nga informacionet

paraprake jane leshuar urdher arrestet per personat e shpallur nga ana jone ne kerkimi (5 shtetasit e sipershenuar), ku jane sekuestruar e sasi vlera monetare dhe dokumenta udhetimi te falsifikuara (pasaporta)(Informacion paraprake vetem 3 jane arrestuar ne kerkim Genc Dibra dhe Zaim Dauti

Referuar akteve dhe rezultateve të hetimeve nga ana e Gjykatës me vendimin penal nr. 71 të dt.16.03.2018 dhe vendimin nr. penal nr. 137 të dt.28.09.2018, për shtetasit nën hetim **Nike Bushi, Adriatik Çekaj, Alfred Kalaj, Mhill Zefi, Mensur Selami, Bedri Bendaj, Ardian Gurakuqi, Kolë Vushaj, Zaim Hysenbelliu, Nosh Volaj, Prel Gjelaj, , Ardian Corri, Kristjan Zallinaj, Sokol Duli, Euglen Dushku, Leonora Dushku, Roza Frroku, Erenik Avdyli, Blerim Brahimi, Oltjan Serani, Kreshnik Muja, Fatos Muja, Luan QYRKU, Genci OSMANAJ, Arben KAJAÇI, Luigj SHTINJA, Tanush PRENGA, Esat ÇAKONI, Eno MUÇOLLARI, Liri MUÇOLLARI, Fuat ZAIMI, Nikolin PRISKA, Haki TARJA, Ylber RAMA, Artur KARAJ,** është caktuar masa e sigurimit arrest në burg masë e cila është ekzekutuar në dt. 16 dhe 17.03.2018 dhe nga gjykata është zgjatur me vendimin e dt. 13.03.2019 afati i paraburgimit për këta shtetas, ndërkohë është caktuar masë ARREST NË BURG NË MUNGESË për të pandehurit:

Bashkim SORRA, , Emiljan SINJARI, Ilija MITREVSKI, Betim VELIU, Artim DAUTI, Zaim DAUTI, Genc DIBRA, Sajmir Hysenbelliu, Enxhi Koci, Ilir Feçi, Skënder KOÇI (KENI), Shkëlqim KOÇI (JIMMY), Borislav, Ivanov KRUMOV, Marin Dimitrov VASILEV, Jorgo Shaho, Përparim KULE. Për këta shtetas megjithë kërkimet e bëra nuk është bërë e mundur ekzekutuimi i masës së sigurimit dhe për këtë arsye është deklaruar mosgjethja e tyre gjatë hetimeve paraprake.

Ndërkohë me vendimin penal nr. 137 të dt.28.09.2018, është caktuar masë sigurimi e cila dhe është ekzekutuar dhe për dy ish punonjës police Almir Doda dhe Edmond Llacini. Masë kjo e ekzekutuar nga policia gjyqësore. Por rezulton se në drejtim të impikimit të këtyre dy personave nën hetim lind e nevojshme të kryhen veprime hetimore të tjera për të konkluduar në lidhje me akuzën ndaj këtyre dy shtetasve. Për këtë arsye kërkohet kohë për të kryer hetime të tjera.

Gjithashtu nga hetimi kompleks dhe voluminoz ka rezultuar se të pandehurit kanë bashkëpunuar dhe me persona të tjerë bashkëpunëtor të tyre dhe për këtë arsye është e domosdoshme të kryhen veprime të tjera hetimore me qëllim realizimin e procesit të identifikimit dhe marrjes së provave konkrete të bashkëpunëtorëve të tjerë.

Për këto arsye që përmendëm në dt. 24.05.2019 u vendos ndarja e procedimeve penale në dy procedime:

1. Në procedimin penal Nr.53 të vitit 2017, në ngarkim të të pandehurve, **Sajmir Hysenbelliu, Enxhi Koci, Nike Bushi, Adriatik Çekaj, Alfred Kalaj, Mhill Zefi, Mensur Selami, Bedri Bendaj, Ilir Feçi, Ardian Gurakuqi, Kolë Vushaj, Zaim Hysenbelliu, Nosh Volaj, Prel Gjellaj, Jorgo Shaho, Ardian Corri, Kristjan Zallinaj, Sokol Duli, Euglen Dushku, Leonora Dushku, Roza Frroku, Erenik Avdyli, Blerim Brahimi, Oltjan Serani, Kreshnik Muja, Fatos Muja, Luan QYRKU, Genci OSMANAJ, Arben KAJAÇI, Luigj SHTINJA, Tanush PRENGA, Përparim KULE, Esat ÇAKONI, Skënder KOÇI (KENI), Shkëlqim KOÇI (JIMMY), Borislav Ivanov KRUMOV, Marin Dimitrov VASILEV Eno MUÇOLLARI, Liri MUÇOLLARI, Fuat ZAIMI, Nikolin PRISKA, Haki TARJA, Bashkim SORRA, Ylber RAMA, Artur KARAJ, Emiljan SINJARI, Ilija MITREVSKI, Betim VELIU, Artim DAUTI, Zaim DAUTI, Genc DIBRA** të akuzuar për veprat penale të “**Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve**” më shumë se një herë, **parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal, kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, krijimit dhe pjesmarrjes në grup të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 333/a-1,2 e 334 të Kodit Penal, si dhe**
2. Në procedimin penal Nr.53/1 të vitit 2017, në ngarkim të personave nën hetim Edmond Llaçini, Almir Doda, Besnik Vuçaj, Adriatik Elmasllari dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të të pandehurve, që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprave penale të “**Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve**” më shumë se një herë, **parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal, kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, krijimit dhe pjesmarrjes në grup të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 333/a-1,2 e 334 të Kodit Penal.**

Këto rrethana provohen me:

Deklarimet e bashkë të pandehurve në këtë procedim të lidhur tashmë të arrestuar si dhe ato të marra nëpërmejt pyetjes së personave të tejrë që kanë dijeni për rrethanat e hetimit (lista e dëshmitarëve bashkëngjitur kërkesës). Dhe këto të dhëna përputhen jo vetëm me përgjimet telefonike, vëzhgimet, dhe aktet marra nga autoritetet e huaja të drejtësisë por dhe me sekuestrimet e telefonave dhe paisjeve kompjuterike gjatë arrestimit të të pandehurve ku sipas akteve të ekspertimit rezultoi që të provohen të gjitha rrethanat e përshkruara të faktit kriminal.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale,

K Ë R K O J:

Dërgimin në gjyq të çështjes nr. 53, të vitit 2017, me të pandehur **Sajmir Hysenbelliu, Enxhi Koci, Nike Bushi, Adriatik Çekaj, Alfred Kalaj, Mhill Zefi, Mensur Selami, Bedri Bendaj, Ilir Feçi, Ardian Gurakuqi, Kolë Vushaj, Zaim Hysenbelliu, Nosh Volaj, Prel Gjellaj, Jorgo Shaho, Ardian Corri, Kristjan Zallinaj, Sokol Duli, Euglen Dushku, Leonora Dushku, Roza Frroku, Erenik Avdyli, Blerim Brahimi, Oltjan Serani, Kreshnik Muja, Fatos Muja, Luan QYRKU, Genci OSMANAJ, Arben KAJAÇI, Luigj SHTINJA, Tanush PRENGA, Përparim KULE, Esat ÇAKONI, Skënder KOÇI (KENI), Shkëlqim KOÇI (JIMMY), Borislav Ivanov KRUMOV, Marin Dimitrov VASILEV Eno MUÇOLLARI, Liri MUÇOLLARI, Fuat ZAIMI, Nikolin PRISKA, Haki TARJA, Bashkim SORRA, Ylber RAMA, Artur KARAJ, Emiljan SINJARI, Ilija MITREVSKI, Betim VELIU, Artim DAUTI, Zaim DAUTI, Genc DIBRA** të akuzuar për veprat penale të “**Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve**” më shumë se një herë, parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal, kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, krijimit dhe pjesmarrjes në grup të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 333/a-1,2 e 334 të Kodit Penal të përshkruar hollësisht në pjesën hyrëse të kësaj kërkesë .

PROKURORI

Eugen Beçi

